

# BARRA PUBLIKE: A vlen për mua?

Barra publike është një test për të parë nëse dikush ka gjasa të bëhet i varur nga programet specifike të qeverisë. Rregulli i barrës publike po kundërshtohet në disa procese gjyqësore. Për lajmet e fundit mbi statusin e proceseve gjyqësore, vizitoni [nyc.gov/publiccharge](https://www.nyc.gov/publiccharge) ose telefononi linjën e drejtpërdrejtë të "ActionNYC" në numrin 800-354-0365 nga ora 9:00 deri në orën 18:00, nga e hëna në të premte.

Kjo informatë NUK është këshillë ligjore. Telefononi linjën e drejtpërdrejtë të "ActionNYC" për të mësuar më shumë dhe për të lënë një takim me një avokat të besuar për këshillim falas. Linja e drejtpërdrejtë është anonime dhe ofrohet në më shumë se 200 gjuhë.

Ju keni **kartë të gjelbër**.



## Rregulli i barrës publike NUK vlen për ju, as kur rinovoni kartën e gjelbër.

Megjithatë, nëse planifikoni të largoheni nga vendi për më shumë se gjashtë muaj, duhet të flisni me një avokat për çështjet e emigrimit.

Po aplikoni OSE tashmë keni një nga statutet e mëposhtme: **Nënshtetësi amerikane, vizë T ose U, azil, refugjat, statusin e veçantë të të miturit emigrant, vetë-aplikues për "VAWA"**.



## Rregulli i barrës publike NUK vlen për ju.

Mund të vazhdoni të përdorni programet qeveritare ku kualifikoheni. Përfitimet e marra kur keni këtë status nuk do të kthehen kundër jush, edhe nëse aplikoni për kartë të gjelbër mbi baza të tjera.

Ju ose anëtari i familjes suaj **planifikoni të aplikoni për kartën e gjelbër, të aplikoni për vizë apo të rinovoni vizën brenda Shteteve të Bashkuara**.



## Përfitoni konsultim për emigrim.

Mund të mos i nënshtroheni akoma testit të barrës publike. Edhe nëse i nënshtroheni testit, përfitimet publike që merrni mund të mos konsiderohen si pjesë e testit. Përveç kësaj, testi nuk vlen nëse jeni duke rinovuar programin e Statusit të Mbrojtjes së Përkohshme (TPS) apo programin e Shtyrjes së Veprimtimit ndaj Emigrantëve Fëmijë (DACA).

Ju ose një anëtar i familjes suaj **planifikoni të aplikoni për një kartë të gjelbër, të aplikoni për vizë apo të rinovoni vizën jashtë Shteteve të Bashkuara**.







## Përfitoni konsultim për emigrim.

Ka një rregull të veçantë për barrën publike dhe udhëzues për aplikimet për kartën e gjelbër dhe për vizë *jashtë* SHBA-së. Këshillohuni me një avokat për çështjet e emigrimit për të marrë informacionet më të fundit mbi udhëzimet për barrën publike. Nëse nuk keni avokat, telefononi linjën e drejtpërdrejtë të "ActionNYC" në numrin 800-354-0365.

# Barra publike: Mos ngurroni të përfitoni kujdes shëndetësor

Rregulli i barrës publike po kundërshtohet në disa procese gjyqësore. Për lajmet e fundit mbi statusin e proceseve gjyqësore, vizitoni faqen e internetit [nyc.gov/publiccharge](http://nyc.gov/publiccharge) ose telefononi linjën e drejtpërdrejtë të "ActionNYC" në numrin 800-354-0365.

	Ndikimi i barrës publike	Masat që mund të ndërmerrni
<b>Përfitimi i kujdesit shëndetësor në NYC Department of Health Clinics, NYC Health + Hospitals dhe qendra komunitare të shëndetit</b>	<p>Përfitimi i kujdesit shëndetësor nuk është një përfitim publik i identifikuar nga rregulli i barrës publike.</p> <p>Nëse i nënshtroheni rregullit të barrës publike, kujdesi ndaj shëndetit tuaj tani, mund të konsolidojë aplikimin për emigrim më vonë.</p>	 <b>Mos ngurroni të përfitoni kujdes shëndetësor!</b>
<b>Medicaid</b>	<p>Shumë emigrantë, përfshirë azilantët, refugjatët, viktima të caktuar nga dhuna dhe persona që tashmë zotërojnë kartë të gjelbër, nuk i nënshtrohen rregullit të barrës publike.</p> <p>Përfituesit e DACA-s kualifikohen për "Medicaid" të financuar nga shteti, që nuk është një përfitim publik i identifikuar nga rregulli i barrës publike.</p>	 <b>Shumica e njujorkezëve që kualifikohen për "Medicaid" mund të regjistrohen pa u shqetësuar për barrën publike.</b> <p>Përfitoni konsultim për emigrim duke telefonuar linjën e drejtpërdrejtë të "ActionNYC" në numrin 800-354-0365.</p>
<b>Emergency Medicaid, Medicaid për gra shtatëzëna, Essential Plan, Child Health Plus ose Qualified Health Plan</b>	<p>Këto nuk janë përfitime publike të identifikuar nga rregulli i barrës publike.</p> <p>Prindërit nuk penalizohen nëse fëmijët e tyre regjistrohen në "Child Health Plus" apo përfitime të tjera.</p>	 <b>Mos ngurroni të regjistroheni!</b>
<b>NYC Care, H+H Options, Charity Care në spitale ose qendra komunitare të shëndetit me çmime sipas mundësisë për të paguar</b>	<p>Këto shërbime nuk janë përfitime publike të identifikuar nga rregulli i barrës publike.</p>	 <b>Mos ngurroni të regjistroheni!</b>

**Kjo informatë NUK është këshillë ligjore. Telefononi linjën e drejtpërdrejtë të "ActionNYC" në numrin 800-354-0365 nga ora 9:00 deri në orën 18:00, nga e hëna në të premte, për të mësuar më shumë dhe për të lënë një takim me një avokat të besuar për këshillim falas. Linja e drejtpërdrejtë është anonime dhe ofrohet në më shumë se 200 gjuhë.**

Nëse mendoni se rregulli i barrës publike mund të ndikojë te ju apo te ndonjë nga anëtarët e familjes suaj, telefononi linjën e drejtpërdrejtë të "ActionNYC" në numrin 800-354-0365.

